



INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM ORIENTUES
PËR PËRGATITJEN E PROVIMIT KOMBËTAR
TË MATURËS SHTETËRORE**

LËNDA:

**GJUHË FRËNGE
(Gjuhë e huaj e dytë)**

Koordinatore: Erifili Hashorva

VITI MËSIMOR 2011 – 2012

1. UDHËZUES I PËRGJITHSHËM PËR PROGRAMIN E PROVIMIT KOMBËTAR TË MATURËS SHTETËRORE PËR LËNDËN E FRENGJISHTES DHE PËR PËRDORIMIN E TIJ NGA MËSUESIT

Programi orientues i provimit kombëtar të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge, si gjuhë e huaj e dytë, përmban në mënyrë të përmbledhur sasinë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë në tri vitet e gjimnazit si në aspektin tematik, ashtu edhe në aspektin gjuhësor e funksional. Mësimi i gjuhës frënge ndihmon në mënyrë të veçantë formimin e përgjithshëm të nxënësit, duke mundësuar pajisjen e tij me një mjet shprehës më tepër, me teknikat dhe metodologjinë e përshtatshme komunikative që do t'i shërbejnë për t'u bërë pjesë e shkëmbimeve të shumëllojshme në situata të larmishme jetësore, si dhe me një mjet më shumë për të njohur botën dhe për të pasuruar dijet.

Për hartimin e këtij programi orientues u morën parasysh korniza kurrikulare e gjuhëve të huaja, standardet e gjuhës së huaj në arsimin parauniversitar, programet e tre viteve të gjimnazit, si dhe tekstet me të cilat zhvillohet mësimi i gjuhës frënge në gjimnaz.

Programi Orientues i Provimit me Zgjedhje të Maturës Shtetërore për Gjuhën e Huaj si gjuhë e huaj e dytë, është ndërtuar duke patur parasysh dhe nevojat e nxënësve për të përmbushur me sukses provimin e gjuhës frënge

Ky program iu nënshtrua diskutimit me mësuesit më me përvojë të gjuhës së huaj dhe u arrit në përfundimin se nxënësit janë në gjendje të përballojnë nivelin **A2** të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

Synimet e programit

Me anë të këtij programi orientues synohet:

- Të ndihmohen nxënësit maturantë në përgatitjen e provimit të gjuhës frënge, si një lëndë me zgjedhje (si gjuhë e huaj e dytë), si edhe mësuesit për të dhënë orientimet e duhura në punën përgatitore me nxënësit.
- të bëhet vlerësimi i njëkohshëm i dy përbërësve të aftësisë së komunikimit, të cilët përbëjnë dy konceptet bazë të kësaj aftësie: të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.
- Të jepen orientime për hartuesit e testeve të provimit kombëtar të Maturës Shtetërore për gjuhën frënge si lëndë me zgjedhje.
- Të vlerësohen të kuptuarit dhe të shprehurit me anë të strukturave gjuhësore bazë, në aspektin e tyre morfologjik, sintaksor, leksikor dhe funksional.
- Të aftësohen nxënësit për të përdorur njohuritë gjuhësore në mënyrë të pavarur, korrekte dhe në përputhje me situatat e larmishme të komunikimit.

Udhëzime praktike mbi përdorimin e programit

Mësuesit dhe nxënësit që do të përdorin këtë program duhet të kenë parasysh faktin që në provim nxënësit do të përballen me një tekst krejt të ri mbi të cilin do të punohet, por tematika, strukturat gramatikore, si edhe aktet e komunikimit do të jenë po ato që janë studiuar gjatë tre viteve.

Mësuesi do të kujdeset që nxënësit të përvetësojnë një sasi të gjerë e të konsiderueshme njohurish leksikore, që ngërthejnë në mënyrë përgjithësuese temat e përfshira në program. Kur flitet për tematikën (p.sh., l'environment, les paysages, le sport, la santé, les voyages, les loisirs l'avenir etj), nuk do të thotë që në provim do të punohet i njëjti tekst që ndodhet në njërin nga librat e tre viteve. Do të zgjidhet një tekst i ri me të njëjtën tematikë, për të cilën nxënësi duhet të jetë në gjendje të përgjigjet.

Për sa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë të aftë të zgjidhin ushtrime gramatikore në një kontekst të ri dhe në situata të ndryshme nga ato që janë paraqitur në librat e tre viteve, duke dalë nga tipi i ushtrimeve tradicionale që jepen nëpër tekste dhe duke praktikuar formate të reja ushtrimesh, ku të përfshihen këto aspekte gramatikore, duke e parapërgatitur nxënësin për ato çfarë do të trajtohen në provimin me zgjedhje të gjuhës frënge të Maturës Shtetërore (si gjuhë e huaj e dytë). Mësuesi të fokusohet në anën praktike të zgjidhjes së ushtrimeve në forma të ndryshme, herë me tipe ushtrimesh me alternativa e herë tipe ushtrimesh të hapura.

Aktet e komunikimit dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që janë studiuar gjatë tre viteve, por të përdorura në mënyrë përgjithësuese në situata të larmishme nga të gjitha fushat e jetës.

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi të përgatisë dhe të aftësojë nxënësit në të shprehurit me shkrim, me qëllim që ata të mund të shkruajnë tekste të qarta e të detajuara për një gamë të gjerë temash, që kanë të bëjnë me fusha të tij të interesit, si: familja, shkolla, udhëtimet, aktualiteti etj. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur të shkruajë një email ose letër formale ose jo formale dhe të zbatojë strukturën e shkrimit të një email-i, një letre formale dhe jo formale.

2. AFTËSITË DHE NJOHURITË QË DUHET TË ZOTËROJË NXËNËSI MATURANT PËR TË QENË I PËRGATITUR PËR PROVIMIN ME ZGJEDHJE TË MATURËS NË GJUHËN FRËNGE SI GJUHË E HUAJ E DYTË

Në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësit do të vlerësohen për dy aftësitë gjuhësore:

2.1 Të kuptuarit me shkrim (leximi dhe kuptimi i një dokumenti të shkruar)

Vlerësimi i këtij komponenti do të bëhet mbi bazën e një teksti të panjohur mbi të cilin do të ndërtohen ushtrime kuptimore.

Nxënësi të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme informacionin e dhënë në pjesën e leximit; informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim të shprehur me gjuhë të thjeshtë mbi atë që i kërkohet në tekste mbi jetën e përditshme (lettres courantes, guides, publicités, annonces, instructions). Për të kryer këtë detyrë, nxënësi duhet të aftësohet që të kapë:

- Marrja e informacionit të duhur nga teksti i dhënë.
- Reflektimi mbi përmbajtjen e një fragmenti dhe nxjerrja e informacionit të duhur prej tij.
- Përgjigjen e pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit.
- Formimi i një kuptimi të përgjithshëm dhe nxjerrja e moralit të pjesës shprehur në gjuhë të thjeshtë.
- Paraqitja e elementëve që justifikojnë përgjigjen e dhënë.
- Marrjen dhe përzgjedhjen e informacionit të duhur brenda një teksti të caktuar;
- Plotësimi i ushtrimeve leksikore rreth tekstit.

2.2 Të shprehurit me shkrim (Shkrimi i një letre formale, ftesë, përshkrim, etj.)

Në provimin e Maturës, nxënësi duhet të jetë në gjendje të prodhojë tekste të shkruara mbi një gamë jo shumë të gjerë temash me tematikë nga jeta e përditshme, duke i lidhur elementet në mënyrë lineare: të bëjë përshkrime jo shumë të hollësishme mbi tema të njohura, të tregojë me shkrim përvojat e tij, duke përshkruar ndjenjat dhe reagimet e tij, të përshkruajë një ngjarje, një udhëtim real duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe të pangarkuar me detaje, të shkruajë një letër personale apo zyrtare, një email formal dhe joformal duke respektuar formatet e mësuara gjatë viteve që nxënësi ka studiuar këtë gjuhë. Për vlerësimin e kësaj aftësie, nxënësi të paraqesë një produkt të shkruar prej 100-120 fjalësh.

Të shprehurit me shkrim përfshin:

- të shprehurit me shkrim do të mbulojë një gamë të gjerë temash të njohura dhe të jetës së përditshme, për të cilat është folur gjatë mësimave në tre vite,
- nxënësi të paraqesë një produkt të shkruar saktë nga ana gramatikore dhe të strukturuar mirë (des courtes lettres formelles et non formelles. mel); application, résumé de courtes textes,
- të shprehë pikëpamjet e tij në formë të thjeshtë dhe të qartë,
- të përdorë një repertor të thjeshtë leksikor,
- të bëjë komente të shkurtra me shkrim për probleme të ndryshme me temë nga jeta e përditshme (des histoires courtes; description des personnes, des lieux, des evenements et des objets).
- të ruajë rendin e mendimeve në të gjithë pjesën e shkruar,
- të përdorë tipe dhe gjatësi të ndryshme fjalësh.

Njohuritë

Njohuritë kryesore leksikore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës gjatë tre viteve të gjimnazit, janë paraqitur përmes ushtrimeve, temave, bashkëbisedimeve që trajtojnë njësi të ndryshme gramatikore ose leksikore, pra në mënyrë esenciale fjalori dhe gramatika e mësuar për tre vite . Në program paraqiten edhe elementet gramatikore të përmbledhura në materialin morfosintaksor, që është zhvilluar e përvetësuar gradualisht e në mënyrë spirale gjatë viteve të gjimnazit.

Shprehitë

Shprehitë kryesore që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit, janë dhënë përmes akteve dhe funksioneve komunikative që përmban programi i gjimnazit, përmes të cilit nxënësi aftësohet t'i ripërdorë në situata të reja e të larmishme komunikimi.

Tipet e ushtrimeve të rekomanduara për çdo tri fushat e sipërpërmendura

Të kuptuarit me shkrim (compréhension des écrits)
<ul style="list-style-type: none">- pyetje mbi përmbajtjen e tekstit,- ushtrime me plotësim të vendeve bosh,- ushtrime të tipit e saktë / e pasaktë,- ushtrime me disa zgjedhje,- gjetja e një informacioni në një tekst,- gjetja e idesë kryesore të një teksti,- ushtrime me alternativa.
Leksiku dhe gramatika (lexique et grammaire)
<ul style="list-style-type: none">- ushtrime me zëvendësim,- ushtrime transformimi,- ushtrime me shumë zgjedhje,- ushtrime me plotësime vendesh bosh,- gjetja e sinonimeve dhe e antonimeve,- shprehja e të njëjtit kuptim me fjalë të tjera, parafrazime etj.
Të shkruarit (production écrite)
<ul style="list-style-type: none">- letër personale,- letër zyrtare,- e-mail,

- ftesa,
- mesazhe,
- përshkrime.

Përdorimi i Gjuhës

- ushtrime me zëvendësim, zëvendësimi i një fjale me një të ngjashmen e saj,
- ushtrime transformimi, shprehja e një fjalie me një strukturë tjetër, por duke ruajtur kuptimin e fjalisë,
- ushtrime me shumë zgjedhje/ alternativa (choix multiple),
- ushtrime me plotësime vendesh bosh, vendosja e fjalës së duhur,
- ushtrime me ndërtim fjalish,
- ushtrime me gjetje dhe korrigjime gabimesh.

Struktura e Provimit në përqindje

FUSHAT	Përqindja
Të kuptuarit me shkrim	40%
Leksiku dhe gramatika	40%
Të shprehurit me shkrim	20%

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fushat tematike dhe leksiku

Përmbajtja tematike e programit është mbështetur në programin e zhvilluar gjatë tre viteve të gjimnazit, por edhe në tekstet shkollore për gjuhën frënge si gjuhë e huaj e dytë. Tematika e parashikuar për provimin e Maturës përfshin temat bazë sipas kurrikulës dhe programeve, si edhe nëntemat që gjenden në tekstet e gjuhës frënge që përdoren në gjimnaz.

Kujdes!

Duke pasur parasysh se shkollat e zhvillojnë mësimin me libra të ndryshëm, tematika është formuluar në mënyrë përgjithësuese dhe jo sipas titujve të mësimëve, me të cilët nxënësit janë familjarizuar, por sigurisht përfshin të gjitha njohuritë e përvetësuara gjatë tre viteve përmes këtyre teksteve:

- le monde du travail,
- l'école et l'éducation,
- les voyages,
- l'environnement,
- pratiques culturelles,
- les relations interpersonnelles,
- culture et civilisation,
- les moyens de communication.

Leksiku

Programi ka karakter tematik. Në bazë të temës, përzgjidhet gjuha dhe integrohet në të përmbajtja leksikore e domosdoshme; aktet gjuhësore, si dhe strukturat gramatikore që mundësojnë realizimin e kuptimit rreth një teme të caktuar—Nxënësi të zotërojë një repertor leksikor të mjaftueshëm për t'u shprehur thjeshtë lirshëm e saktë me shkrim dhe me gojë.

Aktet dhe funksionet komunikative

Propozohen aktet dhe funksionet e mëposhtme, që nxënësi ka fituar gjatë tre viteve të gjimnazit dhe që do të shërbejnë si mjete orientuese për hartimin e testit dhe vlerësimin e nxënësve.

- Demander et donner des explications, des informations.
- Donner et demander un avis, une opinion, p.ex.: je pense que, je crois que, il me semble que?
- Raconter un évènement, exprimer la durée d'une action, p.ex.: Depuis ..., ça fait... il y a ... etc.
- Décrire les personnes ou les circonstances d'un évènement.
- Raconter des actions habituelles ou une suite d'évènements au passé, p.ex.: d'habitude ..., chaque matin + imparfait; d'abord ... , après... , à la fin ... etc.
- Demander et donner des conseils, p.ex.: Il ne fallait pas faire cela!
- Exprimer la cause et la consequence.
- Exprimer le but (pour + inf.).
- Exprimer la condition et l'hypothèse-
- Justifier une opinion ou une action.
- Rapporter les paroles de quelqu'un.

Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore me gojë dhe me shkrim, sugjerohen strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme të trajtuara gjatë tre viteve të gjimnazit:

les modes et les temps verbaux composés

- le présent des verbes du premier, deuxième groupe et des verbes irréguliers,
- le plus-qui-parfait / l'imparfait/ le passé composé,
- le futur / le futur antérieur,
- la concordance des temps de l'indicatif,
- le conditionnel présent,
- le subjonctif présent,
- l'infinitif présent,
- le subjonctif présent,
- le gérondif,
- l'expression de la cause et de la conséquence,
- l'expression du but,
- **les pronoms,**
- complément d'objet direct,
- complément d'objet indirect,
- la place des deux pronoms: ex. Je le lui donnerai,
- les pronoms relatifs,
- les pronoms: y et en,
- les pronoms indéfinis,
- le discours direct / indirect,
- Le comparatif et le superlatif.

Les adjectifs et les pronoms

- l'accord, le genre et la place de l'adjectif,
- l'adjectif et le pronom possessif,
- l'adjectif et le pronom démonstratif,
- l'adjectif et le pronom interrogatif.